

Në bazë të nenit 33.3 dhe 86 të Ligjit për Shoqëritet Tregtare dhe nevojës së ushtrimit të Biznesit, Qytetarët-tani Themeluesit "Granit Jakupi, Durim Emini dhe Patrik Gashi" nga Prishtina më dt. 11 Tetor 2016 lidhin:

#### **AKTIN E THEMELIMIT**

#### **E SHOQËRISË TREGTARE "ALCEDRIX" SH.P.K. NË PRISHTINE, KOSOVË, SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (SH.P.K.)**

##### **Neni 1**

Themeluesi pas nënshkrimit të kësaj Marreveshje do të themelojë Shoqerinë e cila ka statusin juridik të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e në pajtim me Ligjin për Shoqëritet Tregtare.

##### **Neni 2 EMËRTIMI I SHOQËRISË**

2.1. Firma do të afaroj me emërtimin :

SHOQËRIA TREGTARE "ALCEDRIX" - Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

2.2. Emërtimi i shkurtuar : "ALCEDRIX" SH.P.K.

##### **Neni 3 LLOJI I SHOQËRISË DHE ADRESA**

Shoqeria ka statusin juridik : Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Adresa e sëlisë është në: Rr. Zona Qendër, Llam. 7, Lok. 3, 10000 Prishtine, Kosove.

Agent i regjistruar eshte: **Granit Jakupi**.

##### **Neni 4 PERIUDHA E KOHËZGJATJES**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqerise si sh.p.k. do të jetë në afat të pacaktuar.

##### **Neni 5 QËLLIMI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË**

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist, si dhe përfitimi personal dhe ndihma vendit ku jetojne me kontributet dhe taksa të ndryshme.

De. P.A  
Q.7

## **Statuti i një SH.P.K.**

Në përputhje me kërkesat nga neni 33 i Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë në Kosovë, Themeluesit e **ALCEDRIX H.P.K.** si të kufizuar më dt. **08/02/2022** nxjerrin:

# **STATUTIN**

E

## **Alcedrix SH.P.K.**

**Alcedrix SH.P.K.**

**Prishtinë, Prishtinë, Rruga Afrim Zhitija, nr. 43**

**Neni 1**

## **Dispozitat e përgjithshme**

Me këtë Statut rregullohen këto çështje:

- emërtimi i Shoqërisë,
- lloji i shoqërisë,
- adresa e selisë së saj,
- periudha e kohëzgjatjes,
- veprimtaria e shoqërisë,
- llojet e aksioneve të autorizuara për emetim, vlerën e tyre nominale, numrin dhe të drejtat e bartësve të tyre,
- organet drejtuese,
- emrat dhe adresat e themeluesve dhe
- procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret.

**Neni 2**

**EMËRTIMI I SH.P.K.**

Emërtimi i plotë i shoqërisë është: Shoqëria Tregtare **Alcedrix SH.P.K..**

Shkurtimisht: **Alcedrix SH.P.K.**

**Neni 3**

**LLOJI I SHOQËRISË**

Shoqëria Tregtare është **Alcerix SH.P.K.**, shkurtimisht **Alcedrix SH.P.K.**

**Neni 4**

**ADRESA E SELISË**

4.1. Selia e **Alcedrix SH.P.K.** është **Prishtinë, Prishtinë, Rruga Afrim Zhitija, nr. 43.**

4.2. **Agjent i regjistruar** i kësaj shoqërie tregtare është Granit Jakupi, i cili eshte agjent i ligjshem per pranimin e sherbimeve, njoftimeve, kerkesave si dhe akteve tjera qe dergohen nga autoritetet publike.

4.3. Shoqëria mund të themeloi filiala, zyra përfaqësimi brenda vendit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

4.4. Shoqëria operon sipas modelit Partneritet në menaxhim



## **Neni 5**

### **QËLLIMI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË**

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist, si dhe përfitimi personal dhe ndihma vendit ku jetojne me kontribute dhe taksa të ndryshme

## **Neni 6**

### **PERIUDHA E KOHËZGJATJES SË SHOQËRISË**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë si Alcedrix SH.P.K. do të jetë në afat të pacaktuar.

## **Neni 7**

### **VEPRIMTARIA E SHOQËRISË**

Veprimtaria e Shoqërisë është:

**4646 - Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutikë**

**7022 - Aktivitetet e këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për manaxhim**

**4618 - Aktivitetet e ndërmjetësimit të specializuar për shitjen e produkteve të veçanta**

**4619 - Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e një shumëlojshmërie mallrash**

**4676 - Tregtia me shumicë e produkteve të tjera të ndërmjetme**

**4690 - Tregtia me shumicë jo e specializuar**

**4719 - Tregti tjetër me pakicë në dyqane jo të specializuara**

**4773 - Tregtia me pakice e artikujve farmaceutikë në dyqane të specializuara (Barnatore)**

**4774 - Tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjeksorë, në dyqane të specializuara**

*P. M. S. A. R. C.*

**4775 - Tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit, në dyqane të specializuara**

**4779 - Tregtia me pakicë e mallrave të përdorura në dyqane**

**5210 - Magazinimi dhe ruajtja**

**7311 - Agjencitë për publicitet**

**7320 - Hulumtimi i tregut dhe matja e opinionit publik (sondazhet)**

**8690 - Aktivitetet e tjera të shëndetit të njeriut**

**9609 - Aktivitetet e tjera p.k.t.**

## **Neni 8**

### **THEMELUESIT E SHOQËRISË**

8.1. Themeluesit e shoqërisë mund të janë persona fizik ose juridik, që kanë vënë ose do të kenë në zotërim aksione të shoqërisë, me të gjitha mënyrat e parashikuara me ligj.

8.2. Kapitali i përgjithshëm i shoqërisë tregtarë është 1,000.00 €

8.3. Themelues janë:

**Durim Emini - Prishtinë, Muharrem Fejza, Kom. Pozhegu Brodhers, Prishtinë, pjesa në pronësi 333.33 €, Aksionar**


**Granit Jakupi - Prishtinë, Rr-Mitrovica-Obj-4-Hy-2-Nr-10, Prishtinë, pjesa në pronësi 333.34 €, Aksionar**

**Patrik Gashi - Prishtinë, Rr.Zeqir Bajrami Nr.8, Prishtinë, pjesa në pronësi 333.33 €, Aksionar**

8.4. Pronësia mbi aksionet e shoqërisë, përmban aderimin me të drejta të plota në statutin e shoqërisë nëpërmes përfaqësimit në Kuvendin e Aksionarëve.

8.5. Çdo vendim I shoqërisë nuk është I plotfuqishëm nëse nuk është I dakorduar unanimisht nga të gjithë aksionarët.

8.6. Vendimet e para të shoqërisë që do të ndërmirren janë:



8.6.1. Ndarja e përgjegjësive udhëheqëse dhe menaxhuese

8.6.2. Vendimet mbi procedurat standarde të operimeve

8.6.3. Objektivat dhe plani I zhvillimit afat mesëm, për periudhë pesë vjeçare.

### Neni 9

## TË DREJTAT DHE DETYRAT E THEMELUESVE

9.1. Interesat pronësore që mund të quhen “aksion” në **ALCEDRIX SH.P.K.** janë njësítë në bazë të cilave bëhet ndarja e përgjegjësisë në zhvillim, menaxhim, fitime dhe humbje në shoqëri.

9.2. Një interes pronësor në **ALCEDRIX SH.P.K.** është pronë personale e pronarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërsi nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë statut dhe kufizimet e tjera të përcaktuara në Marrëveshjen e shoqërisë.

9.3. Themeluesit e shoqërisë janë përgjegjës për të gjitha borxhet e shoqërisë dhe detyrimet e tjera me të tëra asetet.

9.4. Të gjithë themeluesit apo ndonjeri prej tyre që ndërmarrin veprim në emër të **ALCEDRIX SH.P.K.** duke bërë hapjen e xhillologarive bankare, blerjen dhe dhënjen me qira të pronës, lidhjen e kontravave ose ndërmarrjen e detyrimeve tjera, janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për pretendimet dhe detyrimet që lindin si rezultat i këtyre veprimeve.

9.5. Çdo aksionar ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron.

9.6. Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave, me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legislacioni në fuqi.

9.7. Vlera e aksioneve për një aksionar do të përbëhet nga:

- Vlera neto e fitimit të pa shpëndarë, e pasyruar në raportet mujore te performancës.

- Vlera aktuale e aseteve, komform pjesëmarrjes në aksionet e kompanisë.

- Vlera e obligimeve të pa shlyera të kompanisë, komform pjesëmarrjes në aksionet e kompanisë.

- Vlera e markës së kompanisë.

9.7.1. Çdo aksionar ka të drejtë të tèrhiqet ose largohet nga kompania, duke e transferuar pronësinë e tij proporcionalisht tek aksionarët tjerë dhe duke u kompenzuar konform vlerës aktuale të aksioneve. Aksionari mban përgjegjësi për fitimet ose humbjet e kompanisë, deri në momentin që ai është pjesë e kompanisë.

9.7.2. Përveç vlerës financiare të fitimit të mbajtur (të pa shpërndarë), në momentin që ndonjë aksionar vendos të tèrhiqet vullnetarisht, ai do të përfiton edhe:

9.7.2.1 Kompenzim finanziar nga Asetet e kompanisë, konform vlerës aktuale të tyre si dhe konform pjesës së aksioneve që I posedon në momentin e tèrheqjes nga kompania.

9.7.2.2 Kompenzim të vlerës financiare për fitimet e kompanisë në dy vitet e ardhshme, konform vlerës të përllogaritur nga raportet mujore të performancës dhe konform pjesës së aksioneve në kompani derei në momentin e largimit nga ajo.

9.7.3. Kompenzimi finanziar nga pikat 9.7.1. dhe 9.7.2 (përfshi nënpikat) do të bëhet deri 30 ditë nga dita e tèrheqjes nga kompania. Kompenzimi do të bëhet si I plotë nëse kompania ka mjete financiare për ta shlyer këtë obligim dhe nuk e rrezukan performancën e saj, në të kundërtën do të paguhet në baza mujore, maksimalisht për 2 vite nga dita e largimit nga kompania.

9.7.4. Kompenzimi finanziar nga pikat 9.7.1. dhe 9.7.2 (përfshi nënpikat) nuk vlejnë nëse aksionari largohet nga kompania për shkak të shkeljeve dhe mos kryerjes së obligimeve komform këtij statuti ose marrëveshjeve që bëhen nga kompania.

## Neni 10

### ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Kuvendi i aksionarëve
2. Drejtorët Menaxhues të përcaktuar në bazë të pikës 4.4 dhe nga pika 8.6.1
3. Përfaqësuesi ose agjenti i kompanisë, i përcaktuar nga pika 8.6.1. e këtij statuti

Shoqëria mund të krijoj dhe mbajë edhe një Bord të drejtorëve.

## **Neni 11**

### **KUVENDI I AKSIONARËVE**

11.1. Kuvendi i aksionarëve, qoftë i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm ka kompetenca dhe merr të gjitha vendimet e përcaktuara me Ligjin per shoqëritë tregtare ose Statut.

11.2. Kuvendi i aksionarëve do të mbahet në zyrën e regjistruar të shoqërisë ose në një vend tjetër të caktuar më parë me paralajmërimin për mbledhje.

## **Neni 12**

### **E DREJTA E VOTËS**

12.1. E drejta e votës rrjedh nga zotërimi i aksioneve që përfaqësojnë dhe nga pika 8.5 e këtij statuti.

12.2. E drejta e votës që rrjedh nga përfaqësimi, kërkon një mandat përfaqësimi të shkruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.


## **Neni 13**

### **DREJTIMI I MBLEDHJEVE TË KUVENDIT**

13.1. Thirrja e mbledhjes së Kuvendit bëhet:

- nëpërmes njohtimit të dërguar me letër rekomande në adresën e çdo aksionari me shpenzimet e shoqërisë apo
- ne mënyre elektronike ne email adresat e aksionareve ku patjetër duhet konfirmimi.

13.2. Mbledhjet e Kuvendit të aksionarëve ,drejtohen nga një Kryesues i caktuar nga Kuvendi.



13.3. Gjithashtu mbledhjen e Kuvendit mund ta drejtojnë personat që kane autorizim e ne pajtueshmëri me Ligjin për Shoqeritë Tregtare.

13.4. Kryesuesi cakton një procesmbajtës për të mbajtur procesverbalin lidhur me pikat e rendit të ditës.

#### Neni 14

### PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË KUVENDIT

14.1. Prosesverbalet e mbledhjes së Kuvendit, duhet të mbahen në përputhje me kërkesat e Ligjit për shoqëritë tregtare dhe detyrimisht në fund të saj ,duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi dhe procesmbajtësi.

14.2. Kuvendi i jashtzakonshëm mund të marr vendime vetëm në raste kur ndonjëri nga aksionarët, për arsy shëndetësore dhe nga vlerësimi profesional konkludohet se nuk është I aftë të merr vendime, për arsy të mungesave të pa arsyeshme në mbledhje për kohë të pa caktuar, për arsy se i njejtë është duke u ndjek penalisht ose duke vuajt denim dhe nuk mund të jetë pjesë e mbledhjeve dhe aktiviteteve të shoqërisë.

14.3. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në mbledhjen e parë të paktën 2/3 e aksioneve dhe në të dytën  $\frac{1}{4}$  e aksioneve me të drejtë vote. Në mungesë të këtij kuorumi mbledhja e dytë e Kuvendit mund të shtyhet për një datë të mëvonshme jo më te largët se dy muaj nga data e thirrjes së parë. Ajo merr vendim me një shumicë votash prej  $\frac{3}{4}$  që u përkasin aksionarëve te pranishëm ose të përfaqësuar.

14.4. Kuvendi i zakonshëm merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm nëse aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë  $\frac{1}{4}$  e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën nuk kërkohet asnjë lloj kuorumi.

14.4. Kuvendi i zakonshëm merr vendime vetëm në bazë të pikës 8.5 të këtij statuti.

#### Neni 15

### E DREJTA PËR TË U NJOHUR ME DOKUMENTE

Drejtori menaxhues duhet të paktën 8 ditë para ditës së caktimit të mbledhjes së Kuvendit të iu dërgojë dokumentet e nevojshme aksionerve për tu njohur dhe për të dhënë një gjykim të plotë, mbi administrimin dhe ecurinë e punëve të shoqërisë në fund të vitit, raportet mbi aktivitetin e



shoqërisë, raportin e ekspertit te kontabilitetit, raportin e Këshillit mbikëqyrës, të gjitha projekt vendimet dhe konkluzionet si dhe të gjitha dokumentet tjera të parapara me" "Ligjin për Shoqëritë Tregtare".

## Neni 16

### NËPUNËSIT E SHOQËRISË

16.1. Nëpunësit e Shoqërisë zgjedhen nga Drejtorët menaxhues, në bazë të pikës 8.6.1 të këtij statuti . Shoqëria nuk mund të ketë më pakë se dy nëpunës.


16.2. Kompetencat e nëpunësve parashihen me aktet normative të Shoqërisë si dhe në marrëveshje me Drejtorin menaxhues sipas dispozitave te Ligjit për Shoqërite Tregtare dhe ligjeve tjera relevante.

## Neni 17

### DREJTORI MENAXHUES

17.1. **Drejtor menaxhues i Shoqërisë** emrohet Granit Jakupi i cili do të ushtroi funksionet e tij/saj nën kontrollin e Kuvendit të aksionarëve.

17.2. Drejtori menaxhues mund të shkarkohet për shkaqe të cenimit të ligjit nga Kuvendi i aksionerëve. Si shkaqe të cenimit të ligjit konsiderohen veçanërisht një faj i rëndë i Drejtorit menaxhues, pa aftësia e tij në kryerjen korekte të funckioneve ose kur Kuvendi humb besimin tek ai.

Two handwritten signatures in blue ink are present. The first signature on the left is a stylized 'M'. The second signature on the right consists of 'PG.' above a circle containing 'GA.'

## Neni 18

### KOMPETENCAT DHE KUFIZIMET

18.1 Nëse nuk është përcaktuar ndryshe në pikat 8.6.1 dhe 8.6.2, Drejtori menaxhues ka këto kompetenca:

- të paraqitet, përfaqëson dhe nënshkruan për shoqërinë,
- të ekzekutoi Vendimet e Kuvendit,
- të udhëheq afarizmin e shoqërisë,
- të organizon dhe udhëheq me procesin e punës,
- përgatit pasqyrat vjetore te kontabilitetit dhe raportet mbi afarizmin,
- propozon Vendimet të cilat i nxjerr Kuvendi,
- propozon organizimin e brendshëm të shoqërisë,
- i pranon në punë dhe iu shkëput Kontratën e punës punëmarrësve,
- vendos mbi sistemimin e punëmarrësve në vende pune,
- kujdeset për ligjshmerine e punës në shoqëri,
- vendos mbi procedurat disiplinore të të punësuarve,
- kryen edhe punë të tjera në harmoni me ligjin, Statutin dhe Vendimet e Kuvendit.

18.2. Drejtori menaxhues si përfaqësues i shoqërisë është i autorizuar të lidh Kontrata dhe kryej të gjitha veprimet tjera juridike pa kurrfarë kufizimesh, vetëm nëse nuk është parashikuar ndryshe në pikën 8.6.1. dhe 8.6.2. të këtij statuti.

## Neni 19

### PËRFAQËSIMI

Nga ana ligjore, Shoqëria përfaqësohet nga drejtori menaxhues.

## Neni 20

### NDARJA, BASHKIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, likuidohet ose transformohet në një formë tjetër, përparrë afatit të përcaktuar, me vendim të mbledhjes së zakonshme të aksionerve, në përputhje me parashikimet e "Ligjit për shoqëritë tregtare".

Neni 21

## DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

21.1. Ky Statut hyn në fuqi ditën që e aprovojnë Themeluesit e Shoqërisë.

22.2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës së njejtë si është aprovuar.

23.3. Për të gjitha qështjet që nuk janë përcaktuar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Data: 08/02/2022

Vendi: Prishtinë, Prishtinë, Rruga Afrim Zhitija, nr. 43

Themeluesit:

1. Durim Emini  
2. Granit Jakupi  
3. Patrik Gashi



**Neni 6**  
**KAPITALI THEMELOR**

6.1. Kapitali themelor i ndërmarrjes është 1.000,00 Euro. Ai është i ndarë në 1000 akcione nominative me vlerë nominale prej 1,00 Euro.

6.2. Themeluesit e kompanisë Granit Jakupi (33.34 % respektivisht 333.34 EUR), Durim Emini (33.33% - repsektivisht 333.33 EUR) dhe Patrik Gashi (33.33% respektivisht 333.33 EUR) janë pronar të kapitalit minimal aksionar si dhe pronar të përqindjeve respective të akcioneve të ndërmarrjes.

6.3. Kapitali themelor, mund të ndryshohet me të gjitha mënyrat dhe modalitetet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi.

6.4. Organi kompetent për të vendosur për ndryshimin e kapitalit themelor është Asamblea e aksionarëve e cila merr vendime në bazë të raportit të Drejtorit që përmban treguesit e kërkuar nga ligji.

6.5. Në rastin e zmadhimit të kapitalit themelor me para në dorë, Aksionarët e shoqërisë, kanë një të drejtë parësore në nënshkrimin e tij, proporcionalisht me shumën e akcioneve që ata zotërojnë dhe me përqindjen që I përket në kapitalin e ndërmarrjes.

6.6. Zmadhimi I kapitalit nëpërmes rritjes nominale të akcioneve bëhet vetëm me pëlgimin unanim të aksionarëve, me përjashtim të rastit kur ai realizohet me përfshierjen e rezervave, të fitimeve apo premive të emetimit.

6.7. Ata mund të heqin dorë nga kjo e drejtë, vetëm me shkrim, në mbledhjen e aksionarëve ku miratohet ky zmadhim.

**Neni 7**  
**AKSIONARËT E SHOQËRISË**

7.1. Aksionarët e shoqërisë mund të janë persona fizik ose juridik, që kanë vënë ose do të kenë në zotërim akione të shoqërisë, me të gjitha mënyrat e parashikuara me ligj.

7.2. Pronësia mbi aksionet e shoqërisë, përmban aderimin me të drejta të plota në statusin e shoqërisë nëpërmes përfaqësimit në Kuvendin e aksionarëve.

**Neni 8**  
**TË DREJTAT DHE DETYRAT E AKSIONARËVE**

8.1. Çdo aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndashme të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e akcioneve që zotëron.

8.2. Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të akcioneve sjell pagimin e interesave, me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që

shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

**Neni 9**  
**DREJTORI**

9.1. Drejtori i Shoqerise emrohet: **Granit Jakupi** nga Prishtina, Republika e Kosovës me adresë Rr. Mitrovica Nr. 4, H2/10 i cili do të ushtroi funktionet e tij nën kontrollin e Kuvendit të aksionerëve.

9.2. Drejtori mund të shkarkohet për shkaqe të cenimit të ligjit nga Kuvendi i aksionerëve. Si shkaqe të cenimit te ligjit konsiderohen veqanërisht një faj i rëndë i Drejtorit ,pa aftësia e tij në kryerjen korekte të funckioneve ose kur Kuvendi humb besimin tek ai.

**Neni 10**  
**KOMPETENCAT**

Drejtori ka kompetenca **të përcaktuara me Statut** për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, kompetenca që i ushtron brenda aktivitetit të shoqërisë.

**Neni 11**  
**THEMELUESIT**

Themelues i "Alcedrix" në Prishtine është:

1. Granit Jakupi, Rr. Mitrovica Nr. 4, H2/10, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
2. Durim Emini, Rr. Muharrem Fejza Nr. 22, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
3. Patrik Gashi, Rr. Zeqir Bajrami Nr. 12, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

**Neni 12**  
**PROCEDURAT ME TË CILAT NDRYSHOHEN RREGULLORET**

Përveç Statutit , shoqëria do të nxjerr edhe akte tjera normative të cilat do të ndihmojnë punën e shoqërisë.

Mënyra e ndryshimit të rregulloreve do të jetë e ngjashme me atë të nxjerrjes së rregulloreve.

Më datë: 11 Tetor, 2016

Vendi: Prishtine

Themeluesit:

1. Granit Jakupi

2. Durim Emini

3. Patrik Gashi



Alcedrix Sh.P.K,  
Rr. Afrim Zhitia Nr. 43  
10000 Prishtinë, Kosovë  
NUI: 810857146  
Pristinë, Kosovë

Data: 1 Qershor, 2022  
Vendi: Prishtinë

### VENDIMI NR. 1/2022

Me datë 1 Qershor, 2022 aksionarët e kompanisë Alcedrix Sh.P.K.: 1. Granit Jakupi në cilësinë e drejtorit menaxhues dhe aksionar me nr. personal: 1171461410 , 2. Durim Emini ne cilësinë e aksionarit me nr. personal: 1001160504 dhe me nr. pasaporte: P01030423 dhe 3. Patrik Gashi në cilësinë e aksionarit me nr. personal: 1172906083 të gjitha të lëshuara nga autoritete Kosovare, unanimisht marrin vendimet si më poshtë:

1. Të hapet dega e kompanisë Alcedrix Sh.P.K. në Republikën e Shqipërisë- Alcedrix Sh.P.K. - Dega në Shqipëri qhe do të operoj me emrin tregtar: Alcedrix Albania.
2. Drejtor i degës në Shqipëri caktohet Durim Emiri.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

  
  
\_\_\_\_\_  
**Granit Jakupi - Drejtor Menaxhues dhe Aksionar:**

  
  
\_\_\_\_\_  
**Durim Emini - Aksionar dhe Drejtor i degës në Shqipëri:**

  
  
\_\_\_\_\_  
**Patrik Gashi - Aksionar**